

## **Cilat rregulla vazhdojnë të vlejné në lidhje me kufizimet e kontakteve?**

Deri në datën 18 prill vlejné kufizimet e kontakteve si më tej:

Lejohen takimet në hapësirat publike me maksimumi 5 persona në total, midis pjesëtarëve të një bashkësie familjare dhe pjesëtarëve të një bashkësie tjetër. Fëmijët deri në moshën 14 vjeç (duke e përfshirë këtë moshë) nuk numërohen kur llogaritet numri i personave.

Pavarësisht kushteve të banimit, çiftet konsiderohen një bashkësi familjare. Lejohet ende që të takohet një bashkësi familjare (nuk ka kufizim në lidhje me numrin e personave për këtë bashkësi familjare) me vetëm një person nga një bashkësi tjetër familjare. Fëmijët të cilët kanë nevojë për kujdes mund të shoqërohen nga persona të cilët i përkasin bashkësisë së tyre familjare; në kuadër të ekzistencës të drejtës për vizitë, prindi i ndarë mund të shoqërohet gjithashtu nga fëmija i cili ka nevojë për kujdes.

Përrjashtimet e mëparshme në lidhje me distancën minimale vazhdojnë të vlejné tërësisht të pandryshuara dhe gjenden tek § 2 Paragrafi 2 i Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi Nga detyrimi për ruajtjen e distancës përjashtohen ndër të tjera fëmijët të cilët luajnë në një kënd lojërash, frekuentimi i transportit publik (aty janë të detyrueshme maskat mjekësore) ose shoqërimi dhe mbikëqyrja e të miturve dhe personave në nevojë kujdesi.

Përdorimi i shërbimeve të udhëtimit komunal ose vullnetar, si për shembull udhëtimi drejt qendrave të vaksinimit është gjithashtu i përjashtuar në kontekstin e Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi.

## **Cilat rregulla vlejné në lidhje me detyrimin për mbajtjen e maskës?**

Vazhdon të vlejné në mjedise të caktuara detyrimi për mbajtjen e maskës mjekësore. Maskat mjekësore në kontekstin e Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi janë të ashtuquajturat maska kirurgjike të standardit EN 14683 (kjo duhet të jetë e cilësuar tek paketimi i produktit) ose maskat e standardeve KN95/N95 ose FFP2 dhe maskat e standardeve të larta - por duhet të kini parasysh se asnjëra nga maskat nuk duhet të ketë valvul. Detyrimi për mbajtjen e një maske mjekësore ekziston pavarësisht ruajtjes së distancës minimale

- Në hapësirat e mbyllura të mjediseve tregtare si dhe në klinika mjekësore dhe mjedise të ngjashme ku mundësohen shërbime mjekësore,
- Në hapësirat e mbyllura të muzeve, ekspozitave të artit, galerive, kështjellave, përmendoreve dhe institucioneve të ngjashme si dhe të kopshteve zoologjike dhe parqeve të kafshëve,
- Për evenimentet edukative të cilat zhvillohen me prezencë fizike si dhe provimet e lejuara, të cilat zhvillohen në ndërtesa dhe hapësira të mbyllura

- Në përdorimin e shërbimeve të transportit të cilat përfshijnë transportin publik dhe mjediset e tij si dhe shërbimet e transportit komunal ose vullnetar, si për shembull tek qendra e vaksinimit.
- Në hapësirat e brendshme të mjeteve të tjera të transportit, me përjashtim të përdorimit personal të automjeteve dhe automjeteve të shërbimeve emergjente të agjencive të sigurisë, zjarrfikëseve, shërbimeve mjekësore të urgjencës (ndihma e shpejtë) dhe shërbimeve për mbrojtjen civile,
- gjatë përdorimit dhe ofrimit të shërbimeve të floktoreve si dhe shërbimeve të tjera dhe zanateve e trajnimeve të cilat zhvillohen në afërsi fizike, ku nuk respektohet distanca minimale
- gjatë shërbimeve fetare dhe mbledhjeve të tjera në lidhje me ushtrimin e besimit fetar, edhe në rastet kur personat janë të ulur.

Sipas ligjit federal (SARS-CoV-2-Arbeitsschutzverordnung des Bundesministeriums für Arbeit und Soziales duke filluar nga 21 janar 2021), ekziston gjithashtu detyrimi për të mbajtur një maskë mjekësore tek vendi i punës, aty ku nuk respektohet distanca minimale prej 1.5 metrash. Punëdhënësi duhet të vendosë në dispozicion në këtë rast maskat mjekësore.

Detyrimi për mbajtjen e maskës (të paktën një maskë e thjeshtë) vlen veçanërisht në mjediset e mëtejshme, megjithëse mbajtja e një maske të thjeshtë është ende e mjaftueshme këtu:

- në ndërtesa të mbyllura në hapësira publike, për sa kohë që këto janë të aksesueshme – me ose pa kontroll të hyrjes – nga klientë ose vizitorë,
- tek tregjet ushqimore ose pika të ngjashme shitje në mjedise të hapura,
- në të gjithë sipërfaqen e bizneseve të shitjes me pakicë, në parkingjet përkatëse si dhe në rrugët e hyrjes në një distancë prej dhjetë metrash nga hyrja e dyqanit.

## **Cilat rregulla vlejnë për fëmijët në lidhje me detyrimin për mbajtjen e maskës?**

Për më tepër, fëmijët të cilët janë në moshë më të vogël se mosha e hyrjes në shkollë, janë të përjashtuar nga detyrimi për mbajtjen e maskës. Nëse një maskë nuk i rri si duhet fëmijëve nën moshën 14 vjeç, një maskë e thjeshtë do të mjaftojë në vendet ku një maskë mjekësore është e detyrueshme.

## **Cilat rregulla vlejné në lidhje me detyrimin për mbajtjen e maskës në qendrat e kujdesit ditor të fëmijëve dhe në shkolla?**

- Në shkolla është në fuqi detyrimi për mbajtjen e një maske mjekësore, megjithatë fëmijët deri në klasën e 8-të mund të mbajnë edhe një maskë të thjeshtë, nëse maskat mjekësore nuk i përshtaten (ende).
- Në qendrat ditore të kujdesit për fëmijë detyrimi i mbajtjes së maskës (e këtu bëhet fjalë për maskë mjekësore) vlen vetëm për të rriturit, dhe vetëm nëse ata nuk mund ta ruajnë distancën minimale ndërmjet tyre (pra ndërmjet të rriturve). Kjo vlen më pas edhe për prindërit sidomos gjatë sjelljes dhe marrjes së fëmijëve.

## **Kur do të lejohet hapja e aktivitetit të floktoreve dhe e personave të cilët merren me kujdesin jo-mjekësor të këmbëve? Cilat rregulla vlejné për shërbimet e tjera?**

Shërbimet dhe mjediset e tjera ku ushtrohet zanati, ku nuk respektohet dot distanca prej 1,5 metrash në lidhje me klientët (veçanërisht floktoret, trajtimet e fytyrës, shërbimet kozmetike, shërbimet për kujdesin e këmbëve, qendrat e trajtimit të thonjve, manikyret, masazhi, studiot ku bëhen tatuazhe dhe piercings, por dhe marrja e masave tek rrobaqepësi ose rrobaqepësja), lejohen vetëm nën respektimin e rreptë të masave të higjienës të Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi. Nëse klienti është i lejuar mos ta mbajë maskën ose nuk e mban një maskë gjatë gjithë kohës (për shembull gjatë trajtimeve të fytyrës), këto shërbime ose zanate mund të ushtrohen vetëm nëse ekziston një test ditor për klientët ose paraqitet një test ditor i zhvilluar nga vetë ai, dhe nëse një test i shpejtë ose i kryer vetë mundësohet çdo dy ditë për stafin i cili i ushtron këto zanate ose shërbime.

## **Si është situata ligjore tek sektorët e gastronomisë dhe të mjediseve ku shpenzohet nata?**

Restorantet dhe tavernat do të qëndrojnë të mbyllura deri në një njoftim të dytë, kjo vlen gjithashtu për mensat dhe sallat e ngrënies.

Lejohen vetëm shërbimet ku produktet dërgohen tek konsumatori ose ku merren nga ai me vete për t'u konsumuar jashtë ambienteve të restorantit ose tavernës. Sallat e ngrënies të kompanive dhe mensat në institucione arsimore mund të përjashtohen nga ky rregull dhe të zhvillojnë veprimtarinë e tyre dhe t'u ofrojnë shërbime punonjësve ose përdoruesve të institucioneve arsimore vetëm nëse proceset e punës ose veprimtaria e lejuar edukative pengohet nga mungesa e këtij shërbimi.

Qëndrimet tërë natën për qëllimet private janë akoma të ndaluara. Tek qëndrimet tërë natën për arsye private nuk përfshihen qëndrimet për arsye biznesi/shërbimi.

## **Cilat rregulla vlejné për bizneset e shitjes me pakicë?**

## **Cilat rregulla vlejné për bizneset e shitjes me pakicë?**

Për bizneset e shitjes me pakicë vlejné rregullat si më tej:

1. Qëndrojnë hapur: Dyqanet ku shiten artikuj ushqimorë, shërbimet ku produktet dërgohen tek konsumatori ose ku merren nga ai me vete për t'u konsumuar jashtë ambienteve të restorantit ose tavernës, dyqanet ku shiten pije, tregjet javore të produkteve të freskëta, farmacitë, dyqanet të cilat shesin produkte të shëndetshme, dyqanet të cilat shërbejnë për furnizimin me artikuj mjekësorë, dyqanet ku shiten artikuj për bebe, dyqanet ku shiten artikuj të shumëllojshëm, pikat e karburantit, bankat, bankat e kursimit, zyrat postare, kioskat dhe pikat ku shiten gazetatat, dyqanet ku shiten produkte ushqimore për kafshët dhe ato për kujdesin e kafshëve, shpërndarja e ushqimeve nëpërmjet institucioneve sociale (bankave të ushqimit). Pikat e shitjes me shumicë janë të hapura për klientët e pikave të shitjes me shumicë, kurse klientët e shitjes me pakicë mund të blejnë vetëm ushqime tek to. Qëndrojnë gjithashtu hapur dyqanet ku shiten lule dhe dyqanet e shitjes me pakicë, të cilat shesin lule të prera ose në vazo të cilat vshken shpejt; për sa kohë që i limitojnë shitjet e tyre. Këtu përfshihen dhe aksesorët që lidhen me to.
2. Bizneset e tjera të shitjes me pakicë (pra duke përfshirë kancelaritë, libraritë dhe tregjet ku shiten produkte për kopshte) lejohen të hapen vetëm duke u bazuar tek kufizimet e numrit të personave që hyjnë. Numri i klientëve të cilët mund të jenë prezent në të njëjtën kohë nuk duhet të kalojë 1 klient për 40 metër katror të hapësirës së shitjes. Për më tepër, vetëm klientët të cilët kanë rezervuar një takim më përpara mund të hyjnë në biznes. Takimi duhet të caktohet për një periudhë të kufizuar fikse kohore dhe përdoret për të thjeshtuar procesin e gjurmimit.

## **A lejohet hapja e dyqaneve ku shiten produkte për rregullimin e shtëpive?**

Po. Kjo influencon dhe hapjet e bizneseve të shitjeve me pakicë.

Veprimtaria e dyqaneve ku shiten produkte për rregullimin e shtëpive për të furnizuar personat të cilët ushtrojnë biznes është lejuar prej kohësh dhe është lejuar gjithashtu dhe shitja tek personat privatë e luleve të prera dhe bimëve në vazo që prishen shpejt si dhe e fidanëve të perimeve dhe farave (fara, qepë, patate për tu mbjellë, etc).

Tani e gjithë shumëllojshmëria e dyqanit ku shiten produkte për rregullimin e shtëpive mund të hapet për klientët private, por vetëm me kufizimin e aksesit të cilat vlejné për dyqanet e tjera të sapohapura të shitjeve me pakicë: Numri i klientëve të cilët mund të jenë prezent në të njëjtën kohë nuk duhet të kalojë 1 klient për 40 metër katror të hapësirës së shitjes. Për më tepër, vetëm klientët të cilët kanë rezervuar një takim më përpara mund të hyjnë në biznes. Takimi duhet të caktohet për një periudhë të kufizuar fikse kohore dhe përdoret për të siguruar gjurmueshmëri të thjeshtë.

## **A është e mundur dërgesa e produkteve tek klientët dhe marrja e produkteve nga vetë klientët?**

Po. Edhe pse dyqanet e shitjes së pakicë mund të hapen sërish tani, duke iu nënshtruar kushteve në lidhje me sasinë e klientëve, vazhdojnë veprimtaritë bizneset ku porositen dhe dërgohen produkte, të cilat janë gjithashtu të lejuara.

## **Nën cilat rrethana lejohet mësimi artistik dhe muzikor?**

Duke filluar nga data 8 Mars vlejné këto rregulla: Shkollat e muzikës dhe ato artistike mund të ofrojnë mësim me prezencë fizike për grupe me deri në 5 nxënës.

Këtu duhet të shfrytëzohen maksimalisht hapësirat e mëdha dhe mundësia e mësimit të përzier dhe të alternuar.

## **Cilat rregulla vlejné për hapësirat e trajnimit profesional dhe të arsimit të mëtejshëm?**

Janë të ndaluara tërësisht të gjitha mundësitë e trajnimeve profesionale dhe ato të arsimit të mëtejshëm duke përfshirë edhe mundësitë për kompensimin e arsimit bazë si dhe mundësitë, të cilat shërbejnë për qëllime integrimi. Gjithashtu janë të ndaluara provimet, duke përfshirë ato që zhvillohen në qendrat e edukimit për të rriturit dhe institucionet e arsimit të mëtejshëm me sponsorizim tjetër si dhe programet për të ndihmuar veten. Të përgjashtuar nga kjo ndalesë janë:

- Mësimet individuale ose aktivitete të tjera të arsimit individual jashtë mjediseve të mbyllura,
- Mësimet me prezencë fizike për klasat e viteve të fundit për diplomat e njohura në mbarë vendin, të cilat i përkasin të ashtuquajturës “zweiten Bildungsweg” (Ky term i referohet programeve edukative që e bëjnë të mundur marrjen e një diplome të shkollës së mesme në moshë të rritur, kur kjo shkollë ose nuk është ndjekur fillimisht ose është ndjekur pa sukses),
- Mësimi me prezencë fizike për klasat e viteve të fundit për përgatitjen për një diplomë profesionale
- Provimet me prezencë fizike që lidhen me përfundimin e një arsimit profesional dhe të shkollës së mesme dhe provimet, të cilat i shërbejnë integritetit si dhe aktivitetet përgatitore për të tilla të cilat lidhen me prezencën fizike, nëse ato nuk mund të caktohen në një datë tjetër për arsye ligjore ose faktike ose nëse caktimi i një date tjetër nuk është i arsyeshëm për pjesëmarrësit në provim.
- Shërbimet edukative jashtëshkollore të sponsorizuara me fonde publike për nxënës dhe nxënëse në shkolla në kontekstin e § 1 të Urdhëresës për kujdesin në lidhje me koronavirusin, si dhe programet bazuar në direktivën për nxitjen e mundësive arsimore dhe të kujdesit jashtëshkollor në kohën e koronavirusit për reduktimin e disavantazheve të shkaktuara nga pandemia.

Duke filluar nga data 8 mars, vlejné këto rregulla të reja:

- Shërbimet për ndihmë shtesë në lidhje me mësimet për grupe me jo më shumë se 5 nxënës,
- Programet e institucioneve sociale dhe të atyre për mirëqenien e fëmijës me prezencë fizike të grupeve me deri në pesë nxënës si dhe në mjedise të hapura për grupe me deri në njëzet nxënës deri në moshën 14 vjeç (duke e përfshirë këtë moshë).

Për këto përjashtime duhet që të respektohen me rreptësi masat e ruajtjes së distancës dhe të mbrojtjes nga infeksioni. Përveç kësaj, gjatë zhvillimit të këtyre aktiviteteve duhet të shfrytëzohen sa më shumë të jetë e mundur hapësirat e mëdha si dhe mundësia e mësimit hibrid ose të alternuar.

## **Cilat rregulla vlejnë për autoshkollat?**

Lejohet veprimtaria e autoshkollave, shkollave për pilotë dhe shkollave për drejtuesit e anijeve. Kërkesa për distancën minimale nuk vlen për mësimin praktik, ku vetëm studentë, mësues, kandidatë për mësues dhe persona të cilët mbikëqyrin ekzaminimet mund të jenë prezent tek kabina e pilotit. Këta duhet të mbajnë minimalisht një maskë FFP2.

## **A do të qëndrojnë të hapura universitetet dhe programet jashtëshkollore të arsimit në sektorin publik?**

Veprimtaria e mësimdhënies dhe testimit në universitete dhe tek shkollat e shëndetësisë lejohet duke iu nënshtruar kërkesave të Ligjit për Mbrojtjen nga Infeksioni. Në këtë kuptim, kurset mund të lejohet të zhvillohen me pjesëmarrje fizike vetëm nëse ato nuk zhvillohen dot pa pjesëmarrje fizike ose nëse nuk mund të shtyhen në një datë tjetër pa patur disavantazhe serioze për studentët. Provimet me pjesëmarrje fizike dhe masat përgatitëse për to lejohen vetëm nëse nuk caktohen në një datë tjetër për arsye të forta ose nëse caktimi në një datë tjetër është i paarsyeshëm për personat të cilët do të testohen. Evenimentet e brendshme arsimore duke përfshirë edhe provimet që i përkasin atyre në kuadrin e shërbimeve përgatitore dhe të arsimit profesional, trajnimit të mëtejshëm dhe arsimit të mëtejshëm në shkollat e larta, shkollat dhe institucionet e tjera të ngjashme që i shërbejnë arsimit profesional, trajnimit të mëtejshëm dhe arsimit të mëtejshëm në sektorin publik, si dhe në gjykata dhe institucione shtetërore, nuk lejohen me prezencë fizike të pjesëmarrësve. Të përjashtuara nga këto janë mësimi me prezencë fizike për personat në vitin e fundit dhe në rastin e arsimit profesional që nuk zgjat disa vjet, mësimi me prezencë fizike në pjesën e fundit të arsimit para provimit përfundimtar ose atij të karrierës. Në aktivitete të tilla duhet që të përdoren hapësira sa më të mëdha.

## **A është e detyruar puna nga shtëpia?**

Ministria Federale e Punës ka lëshuar një Urdhëresë (SARS-CoV-2-Arbeitsschutzverordnung des Bundesministeriums für Arbeit und Soziales vom 20. Januar 2021), e cila i kërkon punëdhënësve t'i lejojnë punonjësit të punojnë nga shtëpia kurdo të jetë e mundur. Kështu do të reduktohen kontaktet sociale tek vendi i punës dhe gjatë vajtjes për në punë. Urdhëresa do të hyjë në fuqi në kohën e duhur.

## **Cilat rregulla vlejné për sportet amatore dhe të kohës së lirë?**

Duke filluar nga data 22 shkurt lejohet gjithashtu ushtrimi i sporteve në mjedise sportive në ambient të hapur. Kjo gjë është lejuar prej nga ajo datë për sportet e zhvilluara vetëm, në çift ose me pjesëtarët e bashkësisë familjare të vetë personit dhe duke filluar që tani, nga data 8 Mars, edhe me deri në 5 njerëz të cilët i përkasin jo më shumë se 2 bashkësive familjare. Grupet me jo më shumë se 20 fëmijë, të cilët i përkasin moshave 14 vjeç e poshtë, të shoqëruar me deri në dy instruktorë ose persona mbikëqyrës mund të marrin pjesë gjithashtu në sportet në mjedis të hapur bashkarisht.

Brenda këtyre grupeve nuk është nevoja të ruhet distanca gjatë ushtrimit të sporteve. Por midis grupeve të ndryshme ose në lidhje me individë të tjerë në mjedisin sportiv duhet të ruhet një distancë minimale prej 5 metrash.

Duke filluar nga data 22 shkurt 2021, lejohet sërish trajnimi sportiv me mësim privat tek mjediset e sportit në ambient të hapur.

Përdorimi i mjediseve të përbashkëta, duke përfshirë dhomat e zhveshjes dhe ato për të bërë dush tek mjediset sportive është i ndaluar.

Veprimtaria e palestrave, pishinave për notim dhe mjediseve të ngjashme është gjithashtu e ndaluar.

## **Çfarë do të ndodhë me evenimentet kulturore?**

Koncertet dhe shfaqjet në teatro, opera dhe salla koncerti, kinema dhe institucione të tjera kulturore private ose publike ndalohen deri në 18 prill 2021. Evenimente të tilla lejohen në mjedise të jashtme vetëm nëse performuesit mbajnë një distancë minimale prej 2 metrash dhe audienca e ndjek evenimentin nga banesat e tyre (të ashtuquajturat koncerte në dritare).

## **Cilat rregulla vlejné për muzikantët profesionistë?**

Lejohet veprimtaria provë, e cila është pjesë e ushtrimit të profesionit. Gjithashtu i lejohet muzikantëve profesionistë, të zhvillojnë koncerte dhe shfaqje pa audiencë me qëllim regjistrimin e tyre ose për t'u transmetuar në radio dhe internet.

## **Cilat rregulla vlejné në lidhje me institucionet kulturore si dhe me mjediset e kohës së lirë dhe të argëtimit?**

Këtu ka gjithashtu ndryshime.

Vazhdon të jetë e ndaluar veprimtaria e

- pishinave për notim dhe argëtim (me përjashtim të trajnimit për fillestarë me grupe prej jo më shumë se pesë fëmijësh), saunave dhe banjave termale si dhe mjediseve të ngjashme,

- këndeve të brendshme të lojërave dhe mjediseve të ngjashme të kohës së lirë,
- sallave të lojërave, kazinove dhe mjediseve të ngjashme,
- klubeve, diskotekave dhe mjediseve të ngjashme,
- bordellove, mjediseve ku zhvillohet prostitucioni dhe mjediseve të ngjashme,
- ekskursioneve me anije, karroca, trena historikë dhe mjediseve të ngjashme.

Veprimtaria e salloneve për nxirje artificiale lejohet sërish nëse përmbushen kërkesat e urdhëresës për higjienën, sepse këtu shërbimi nuk ofrohet nga njeriu në njeri.

Në pikat dhe bizneset e basteve, lejohet vetëm marrja e biletave, basteve, etj. Nuk lejohet qëndrimi i mëtejshëm (për shembull për të parë lojëra dhe evenimente të cilat lidhen me bastet).

Lejohet duke filluar nga data 8 mars, vizita e muzeve, ekspozitave të artit, galerive, kështjellave, përmendoreve dhe institucioneve të ngjashme, vetëm duke rezervuar takimet më përpara dhe duke siguruar gjurmueshmëri të thjeshtë. Në mjedise të mbyllura, numri i vizitorëve të pranishëm në të njëjtën kohë nuk duhet ta kalojë atë të një personi për 20 metër katror të sipërfaqes së hapur për vizitorët.

Gjithashtu lejohen sërish me rezervim takimi të bërë më përpara dhe me gjurmueshmëri të siguruar, vizitat tek kopshtet zoologjike dhe parqet e kafshëve. Gjithashtu në hapësira të mbyllura numri i vizitorëve të pranishëm në të njëjtën kohë nuk duhet të kalojë 1 person për 20 metër katror.

## **A janë sërish të mundura evenimentet dhe mbledhjet?**

Jo, nuk janë akoma të mundura. Evenimentet dhe mbledhjet, të cilat nuk bëjnë pjesë tek rregulloret speciale të Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi, do të qëndrojnë të ndaluara për momentin.

Lejohen ndër të tjera nën kushte të cilat përcaktohen sipas rastit:

- Mbledhjet sipas ligjit për mbledhjet (për shembull demonstratat)
- Evenimentet të cilat i shërbejnë nevojave thelbësore të popullatës, mirëmbajtjes së sigurisë dhe rendit publik ose evenimentet të cilat sigurojnë mirëqenien e publikut (për shembull mbledhjet partiake për nominimin e kandidatëve elektoralë ose dhurimet e gjakut)
- Takimet e organeve të përcaktuara me ligj për vetëqeverisjen lokale
- Mbledhjet e komiteteve ligjore, shoqërive, partive, klubeve, shoqatave të pronarëve të shtëpive, të cilat nuk zhvillohen dot dixhitalisht
- Funeralet, duke përfshirë shërbimin funeral paraprirës
- Ceremonitë civile
- Shërbimet fetare

## **Cilat rregulla vlejné për shërbimet fetare dhe mbledhje të tjera në lidhje me ushtrimin e besimit fetar?**



Kishat dhe komunitetet fetare e vendosin deri në çfarë pike mund të mblidhen njerëzit fizikisht, duke pasur parasysh situatën lokale të infeksionit dhe duke informuar autoritetet përgjegjëse vendore.

Ata sigurojnë mbajtjen e distancës minimale, kufizimin e numrit të pjesëmarrësve, paraqitjen e kërkesës për regjistrim për ato mbledhje ku pritet një numër i tillë vizitorësh i cili mund ta kalojë kapacitetin, i kërkojnë pjesëmarrësve të mbajnë një maskë edhe kur ulen (të ashtuquajtura maska kirurgjikale ose maskat e standardeve KN95/N95 ose FFP2), regjistrojnë të dhënat e kontaktit të pjesëmarrësve dhe ndalojnë këndimin në kongregacion.

Rregulloret e përgatitura sipas § 1 Paragrafi nr.3 i Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi nga kishat dhe komunitetet fetare për shërbimet fetare dhe mbledhjet e tjera për ushtrimin e besimit fetar duhet të dorëzohen tek:

- Staatskanzlei e Landit të Nordrhein-Westfalen nëpërmjet kishave dhe organizatave gjithëpërfshirëse të tjera të komuniteteve fetare. Për këtë qëllim, kishat dhe organizatat gjithëpërfshirëse të tjera të komuniteteve fetare mund të na kontaktojnë këtu me email: [Referat\\_I\\_B3@stk.nrw.de](mailto:Referat_I_B3@stk.nrw.de).
- Komuna përkatëse nga komunitete fetare dhe shoqatat të cilat nuk i përkasin një kisha ose organizate gjithëpërfshirëse.

Komunitetet, të cilat i përkasin një kisha ose një organizate gjithëpërfshirëse, janë të detyruar t'i koordinojnë planet për mbrojtjen nga Koronavirusi me kishën ose organizatën gjithëpërfshirëse përkatëse.

Cili është kuptimi i termit “Frenat e emergjencës për Koronavirusin”?

Nëse incidenca 7-ditore është mbi vlerën 100 për tre ditë rresht në një qark ose qytet pa qark, e ashtuquajtura Frena e Emergjencës për Koronavirusin hyn në fuqi në ditën e dytë të mëtejshme të punës.

Në këtë rast, çdo hapje e cila është në fuqi anulohet dhe hyjnë sërish në fuqi kufizimet më të rrepta. Për shembull persona nga një bashkësi familjare mund të takohen vetëm me jo më shumë se një person nga një bashkësi tjetër familjare. Për më tepër, ndalohet për shembull veprimtaria e dyqaneve joditore të shitjes me pakicë, me përjashtim të dërgesës dhe marrjes së produkteve të porositura. E njëjta gjë vlen për mundësimin e shërbimeve në afërsi fizike me përjashtimin e shërbimeve të nevojshme nga ana mjekësore, floktoreve dhe shërbimeve jomjekësore për kujdesin e këmbëve. Nëse numrat bien nën vlerën e 100 për tre ditë rresht, atëherë kufizimet do të hiqen sërish.

Përveç kësaj vlen për komunat e afektuara koncepti i ri i “Test-Option”. Kjo do të thotë se komunat mund të urdhërojnë me një dekret të përgjithshëm në përputhje me MAGS (Ministria e Punës, Shëndetësisë dhe çështjeve sociale) që përdorimi i ambienteve të përmendura më lart të qëndrojë i lejuar sipas rregulloreve të zbatueshme si më para, nëpërmjet një testi të shpejtë ditor të konfirmuar me një rezultat negativ. Kërkesa paraprake për këtë është një program përkatës i mjaftueshëm për testim falas për qytetarët. Kjo nuk ndikon tek rregulloret më të rrepta në lidhje me kufizimet e kontakteve, të cilat vazhdojnë të vlejnë edhe në komuna me një dekret të tillë të përgjithshëm.

Rregulloret për qarqet dhe qytetet pa qarqe mund t'i gjeni këtu me detaje: [Link për përmbledhjen e masave](#):

## **A keni pyetje në lidhje me Urdhëresën për Mbrojtjen nga Koronavirusi?**

Atëherë na shkruani tek adresa e email [corona@nrw.de](mailto:corona@nrw.de)